



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR BURSË STUDIMI NË REPUBLIKËN SLOVAKE
PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**

Ministria e Arsimit, Kërkimit, Zhvillimit dhe Rinisë e Republikës së Sllovakisë ka publikuar thirrjen për 100 bursa studimi universitare për të gjithë studentët nga e gjithë bota, të cilët dëshirojnë të studiojnë në institucionet shtetërore të arsimit të lartë të Republikës së Sllovakisë për vitin akademik 2024-2025.

Aplikantët të cilët do të fitojnë do të kenë të drejtën e një burse prej 4 000 € për vit akademik, pra gjithsej 12 000 € për tre vitet e para të arsimit të lartë në programet e studimit të diplomës bachelor ose në programet e përbashkëta të studimit bachelor dhe master.

Studentët e interesuar duhet të aplikojnë deri më 30 qershor 2024 në linkun e mëposhtëm:
<https://scholarships.portalvs.sk/>.

Aplikantët mund të zgjedhin nga çdo institucion të arsimit të lartë publik ose privat, si dhe çdo program studimi me kohë të plotë. Lista e programeve të studimit në gjuhën angleze të ofruara në Sllovaki ndodhet në faqen e internetit: <https://www.portalvs.sk/en/studijne-odbory?from=menu1>

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE
ASISTENCËS**